

**STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

"Harper Hill Holdings" shpk

Sot me date 7 Janar 2025, me cilesine e "ortakeve themelues", ortaket e shocierise Alterra RE Holdings LLC, Brian Eisenberg me numer dokumenti identifikimi A44689600, Ashley Eisenberg me numer dokumenti identifikimi 530734524, dhe Julian Veshi me numer dokumenti identifikimi 565477969, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, me vullnet te lire e te plote, hartojne kete statut te *shoqerise me pergjegjesi to kufizuar, me emertimin "Harper Hill Holdings" shpk*, ku shocieria Alterra RE Holdings LLC me NUIS (NIPT) L24000442402 do te jete ortake e vetme.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shocieria "Harper Hill Holdings" shpk eshte person juridik i te drejtes Shqiptare, Shocieri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shocieria").

Neni 2
Personaliteti Juridik

Shocieria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ("QKB"), ne perputhj e me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shocieria "Harper Hill Holdings" shpk, eshte nje shocieri tregtare, e themeluar nga ortaket, te cilet nuk pergiqjen per detyrimet e shocierise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shocierise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te Shocieri se.

Ortaket gezojne kuoten e tyre ne Shocieri, ne perpjasetim me kontributin qe kane dhene ne kapital.

Neni 3
Selia

Shocieria e ka seline kryesore ne Rruga "Lord Bajron", Pallati 35/1, Laprake, Tirane.

Shocieria mund te ndryshoje seline, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 4
Objekti i Veprimtarise

Objekti i Shocierise eshte blerj a, menaxhimi, zhvillimi, dhe shitja e pronave te paluajtshme ne Shqiperi.

Neni 5
Kohezgjatja

Shocieria do te zhvilloje aktivitetin per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shocierise eshte 10,000 leke, vetem 1 kuote. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar teresisht nga ortaket e Shocierise perkatesisht: Alterra RE Holdings LLC, zoterues i 1 kuote, qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shocierise, me vlere te pergjithshme 10,000 leke.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga Tetra me vlere te tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaku qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shocierise, ka te drejte t'i kerkoste gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

Neni 7
Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i Shocierise mund te zmadhohet nepermj et nenshkrimive te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime, nepermj et emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i Shocierise mund te zvogelohet me vendim te ortakeve me te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet QKB per regjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 8
Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te Shocierise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermj et:

- (a) kontributit ne kapitalin e Shocierise;
- (b) shitblerj es;
- (c) trashegimise;
- (d) dhurimit; dhe
- (e) cdo menyre tj eter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

**KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 9
Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i Shocierise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve organi i vetem vendimmarres i Shocierise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per Shocierine per ceshq et e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare te Shocierise;
- (b) ndryshimet e statutit;
- (c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- (d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- (e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronj at "c" dhe "d" te kesaj pike;
- (f) mbikeqyrj en e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatifi en e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- (i) pj esetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- (j) perfaqesimin e shocierise ne gjykate dhe ne procedimet e tj era ndaj administratoreve;
- (k) riorganizimin dhe prishj en e shocierise;
- (l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhj eve te asamblese; dhe
- (m) ceshq e te tj era te parashikuara nga ligji apo statuti.

Secili ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene se Pergjithshme te Ortakeve ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tj eter apo nga nje person i trete.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblene se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhj et vijuese me te njejtin rend dite.

Administratori i Shocierise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 10
Administrimi

Administrator i Shocierise do tejete z. **Agim Veshi.**

Administratori i Shocierise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riparteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Administrator i Shocierise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- (a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shocierise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (b) perfaqesoj e Shocierine tregtare;
- (c) kujdeset per mbajtj en e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shocierise;
- (d) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, t'i paraqesi keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim;
- (e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtj en e veprimtarise dhe ekzistencen e Shocierise;
- (f) kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te Shocierise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- (g) ne respekt te dispozitave ligjore, te kryeje gjitha operacionet qe do tee te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishme per te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete; dhe
- (h) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shocierise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrasi Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur:

- (a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shocierise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim; dhe
- (b) brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te Shocierise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoquerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private, vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaj a, perfshi ketu autoritetet gjyquesore te gjitha shkallevet. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te Shoquerise, ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe ky statut is jep shprehimisht ortakeve te Shoquerise.

Administratori angazhon Shoquerine ne marredheniet mete tretet nepermjet akteve qejane ne perputhje me objektin e Shoquerise.

Shoqueria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretave kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e Shoquerise ose kur te tretet nuk mund to injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mj aftueshme.

Neni 12
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKB dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 13
Bilanci i Shoqerise

Brenda 6 muajsh nga mbyllj a e vitit financiar, Asamblej a e Pergjithshme e Ortakeve miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Neni 15
Dividentet

Te ardhurat neto te Shoqerise (Dividentet) qe mbeten pas vecimit te fondevi ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te tretave, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividenteve, pasi te jene zbritur humbj et e vitit te meparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16
Prishja e Shoqerise

1. Shoqeria prishet:

- (a) kur mbaron kohezgj atj a, per te cilin eshte themeluar;
- (b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
- (c) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunkcionimit te vazhduar te organeve te Shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
- (d) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te sShoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 i ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- (e) ne raste te tj era, te parashikuara ne statut;
- (f) ne raste te tj era, te parashikuara me ligj; dhe
- (g) per cdo shkak tjeter te vendosur nga Asamblej a e Pergjithshme e Ortakeve.

2. Prishja e Shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "e", "f" dhe "g", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87, te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

3. Ne rast mosveprimi te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per te vendosur prishj en, per shkaqet e percaktuara ne shkronj at "a", "c", "e", dhe "f", te pikes 1, te ketij neni, cdo person i interesuar mund, ne cdo kohe, t'i drejtohet gjykates per te konstatuar prishj en e Shoqerise.

4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistanca e nje a me shume shkaqeve, te

parashikuara nga shkronjat "a", "c", "e", "f" dhe "g", te pikes 1, te ketij neni, nuk do te kete si pasoje prishjen e Shocierise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, te permendur ne piken 3, te ketij neni, shkaku i prishj es eshte korriguar, nese eshte e mundshme te korrigohet, dhe ky korrigjim eshte publikuar nga Shocieria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

5. Prishja e Shocierise, si pasoje e shkacieve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e Shocierise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendsos rezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se Shocierise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.

6. Prishja e Shocierise si pasoje e shkacieve te parashikuara ne shkronjen "d", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shocierite tregtare".

Neni 17
Likuiduesit

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emerimit te tij.

Nese Shocieria emeron me shume se nje likuidues, perverse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji.

Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posacme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrj es se e ortakeve dhe administratorit.

Neni 18
Te Drejtat e Detyrimet e Likuiduesit

Detyra e likuiduesve eshte mbyllj a e te gjitha veprimeve te Shocierise, mbledhj a e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te Shocierise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te rej a tregtare, per mbyllj en e nje veprimi te paperfunduar.

Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, sipas nenit 194 te ligjit "Per tregtaret dhe shocierite tregtare", likuiduesit verejne se pasuria e Shocierise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen to pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi percatit nje bilanc te gjendjes se Shocierise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me

shume se nje vit, likuiduesi percatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te Shogerise. Bilancet miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

Neni 19
Perfundimi i Likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton QKB, per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shogerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 20
Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njerës ose me shume prej shoqefive, që quhen shoqefite e perthithura, te nje shoqeri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqefia perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te ketij shoqefie. Ky proces quhet bashkim me perthithje; ose
2. Themelimit te nje shoqefie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqefive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shogerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqefie te re.

Neni 21
Ndarj a

Shogeria mund te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqefive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shogeria qe ndahet, vleresohet e prishur.

Per ndarjen e Shogerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve te ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqefite tregtare" ndryshuar me ligjin 129/2104.

Shoqefite qe fitojne pasurite e shogerise qe ndahet quhen shoqeri pritese dhe pergiqjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.

Regjistrimi i ndarjes se Shogerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ka si pasoje:

- (a) kalimin te shoqefite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shogerise qe ndahet, ne perputhje me reportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermj et shoqefive, si dhe per palet e treta;
- (b) berj en e aksionareve/ortakeve te shogerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqefive pritese, ne perputhje me reportin e ndarj es, percaktuar ne marreveshj en e ndarj es;
- (c) vleresimin e shogerise qe ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e saj nga "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, "Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar pa kryerj en e likuidimit.

Neni 22
Shnderrimi

Shogeria mund to ndryshoje formen e vet ligj ore, nepermjet shnderrimit te tij ne shoqeri aksionare.

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që Shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 23
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqërite tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërise.

Neni 24
Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe te tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25
Dispozita perfundimtare


Ky statut i Shoqërisë “Harper Hill Holdings” shpk, u redaktua “ortakët themelues” në 4 ekzemplare me vlera të njëjtë juridike në gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera të njëjtë juridike.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “HARPER HILL HOLDINGS” SHPK


Alterra RE Holdings LLC

DocuSigned by:

Brian Eisenberg
DE8BC56908694C1...

Brian Eisenberg

DocuSigned by:

Ashley Eisenberg
EE34E87F2D6D4CA...

Ashley Eisenberg

Signed by:

Julian Veshi
A182418DB6664AF...

Julian Veshi